

K O N T R A T E

E THEMELIMIT TE SHOQERISE PRIVATE "R.I.A.-2000" SH.P.K.

Lidhur midis:

ROLAND JARANI- banues ne Tirane, rruga Cerciz Topulli Nr.31, I quajtur me poshte ortakut I pare.

ILIR JARANI- banues ne Tirane, rruga Cerciz Topulli Nr.31, I quajtur me poshte ortakut I dyte.

Dy ortaket rane dakort sa vijon:

NENI 1

Te krijojne nje shoqeri te perbashket me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "RIA-2000"

NENI 2

Shoqeria RIA-2000 ka statusin e personit juridik shqiptar. Selia e saj eshte ne rrugen Muhamet Gjolllesha ,pall.42/1 ne Tirane. Ajo ka te drejte te cele dege, filiale apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar apo edhe jashte tij, ne perputhje me ligjet e vendit ku ato ngrihen.

NENI 3

Veprimtaria e kesaj shoqerie, maredheniet qe linden nga kjo kontrate si dhe maredheniet me persona te tjere juridik dhe fizike shqiptar dhe te huaj, rregullohen sipas legjislacionit shqiptar, kesaj kontrate dhe statutit bashkelidhur.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj. Ajo nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket kane pasur para krijimit te saj, ose per detyrimet e ortakeve qe marrin persiper si persona fizike, tej veprimtarise se shoqerise. Po ashtu ortaket nuk pergjigjen personalisht per detyrimet e shoqerise dhe nuk perballojne personalisht humbjet e shoqerise tej kontributit te derdhur nga secili ne kapitalin themeltar.

NENI 4

Veprimtaria e shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete kontrate, mund te ndryshojne vetem sipas nje vendimi me shkrim te Asamblese se ortakeve.

NENI 5

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

1. Tregetimi I pjeseve te kembimit, gomave dhe vajrave per automobila.
2. Riparime mekanike te automobilave.
3. Riparim I impianteve elektrike dhe ushqimit te automobilave.
4. Riparim dhe zevendesim I gomave.
5. Riparim dhe lysterje e karrocive te automobilave.
6. Import-export I automobilave te rinj dhe te perdorur.
7. Import-export I pjeseve te kembimit, gomave dhe vajrave per automobila.
8. Tregetim motorcikletash.
9. Tregetim pjese kembimi per motorcikleta.
10. Riparim motorcikleta.
11. Import-export motorcikleta.



12. Tregetim automobilash te rinj dhe te perdorur.

Ajo mund te kryeje edhe cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte e ngjashme me ate te mesiperme ose plotesuese e tyre.

Per arritjen e qellimit te saj, shoqeria mund te beje cdo lloj veprimi tregtar e industrial, financiar e pasuror qe do te quhet e nevojshme prej organit administrativ, si dhe mund te marre pjese me cdo lloj forme ne shoqeri apo ndermarrje te tjera, qe kane te njejtin objekt apo te ngjashem me te.

NENI 6

Kapitali fillestar I shoqerise eshte 100.000 leke. Pjesa e ortakeve ne kapitalin fillestar te shoqerise eshte:

Ortaku I pare 50.000 leke ose 50% .

Ortaku I dyte 50.000 leke ose 50%.

Kapitali I derdhur per krijimin e kapitalit fillestar eshte ne leke. Kuotat e ortakeve dhe pjeset e kapitalit te shoqerise shenohen ne librin e llogarise se shoqerise. Ato mund te depozitohen ne nje nga bankat e Shqiperise, ku shoqeria do te cele llogarine rrjedhese te saj.

Ne librin e llogarise krijohet fondi themelor I shoqerise, ku shenohen kapitalet e vena nga secili ortak.

Ortaket nuk kufizohen ne rritjen e kontributit te tyre, I cili mund te jete ne leke ose ne natyre me vleresim nga te dy palet.

NENI 7

Kjo kontrate lidhet per nje afat kohor prej 10 (dhjete) vjetesh, duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise si person juridik, me te drejten e zgjatjes se ketij afati. Ortaket kane te drejte te heqin dore nga kjo kontrate duke njoftuar me shkrim Asamblene e ortakeve nje muaj me pare.

NENI 8

Fitimi I realizuar nga shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe zbritjes se fondeve te tjera, I nenshtrohet taksave sipas legjislacionit ne fuqi. Pjesa e mbetur ndahet midis ortakeve perpjestimisht me pjesen qe I takon secilit ne kapitalin e shoqerise.

NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asamblea e ortakeve.
2. Administratori I shoqerise.
3. Komisioni I kontroll revizionit.

Menyra e krijimit dhe funksionimit te tyre percaktohet ne statut.

NENI 10

Ortaket detyrohen te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informatave, te njohurive dhe te pervojës se shkëmbyer ose te realizuar ne kuadrin e shoqerise dhe te marrin te gjitha masat e nevojshme per te shmangur perhapjen e tyre qofte edhe pjeserisht. Ortaket pergjigjen per pasojat e demshme per nje shkelje te mundshme te ketij detyrimi, kur kjo shkelje eshte rrjedhim I ndonje veprimi te qellimshem ose nga pakujdesia.

NENI 11

Mosmarveshjet qe mund te lindin ortakeve dhe qe nuk zgjidhen me mirekuptim do te kalohen per shqyrtimin perkates ne gjykatën e Tiranës.

NENI 12

Dispozita me te hollësishme per shoqerine percaktohen ne statutin e saj.

NENI 13

Kjo kontrate hartohet ne tre kopje, nje per ortakun e pare , nje per ortakun e dyte dhe nje per zyren e noterise duke pasur vlera te barabarta juridike.

Tirane me

ORTAKU I PARE


Roland JARANI

Roland Jarani

ORTAKU I DYTE


Ilir JARANI

Ilir Jarani



**STATUT
I
SHOQERISE PRIVATE R.I.A 2000 SH.P.K**

KREU I PARE

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria e themeluar ka marre emrin R.I.A 2000 dhe eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 2

Shoqeria ka kete statut, ne perputhje me kontraten e themelimit dhe ligjin Nr.7512 date 10.08.1991, pjesen e pare te Kodit Tregtar te Republikes se Shqiperise dhe ligjin mbi Shoqerite ne Republiken e Shqiperise me Nr. 7632 date 04.11.1992, Nr. 7638, date 19.11.1993. Te gjitha keto rregullojne poziten juridike te ortakeve dhe te punonjesve te shoqerise, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

NENI 3

Shoqeria ka statutin e personit juridik dhe vulen e saj.
Ajo fiton te drejten e personit juridik, qe nga data e rregjistrimit ne Gjykatën e rrethit Tirane.

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj .

NENI 4

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte:


1. Tregtimi I pjeseve te kembimit, gomave dhe vajrave per automobila.
2. Riparime mekanike te automobilave.
3. Riparim I impianteve elektrike dhe ushqimit te automobilave.
4. Riparim dhe zevendesim I gomave
5. Riparim dhe lysterje e karrocereve te automobilave.
6. Import-export I automobilave te rinj dhe te perdorur.
7. Import-export I pjeseve te kembimit, gomave dhe vajrave per automobila.
8. Tregtim motorcikletash.
9. Tregtim pjese kembimi per motorcikleta.
10. Riparim motorcikleta.
11. Import- export motorcikletash.
12. Tregtim automobilash te rinj e te perdorur.

Ajo mund te kryeje edhe cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte e ngjashme me ate te mesiperme ose plotesuese e tyre.

Per arritjen e qellimit te saj shoqeria mund te beje cdo lloj veprimi tregtar, industrial, financiar dhe pasuror, qe do te quhet e nevojshme prej organit administrativ, si dhe merr pjese ne cdo lloj forme ne shoqeri apo ndermarrje te tjera qe kane te njejtin objekt me te saj in apo te ngjashem me te.

NENI 5

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, ne Republiken e Shqiperise dhe konkretisht ne rrugen Muhamet Gjollesha, pall 42/1 ne Tirane. Ne rast ndryshimi te kesaj adrese



do te behet njoftimi perkates. Ajo mund te cele dege, filiale e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise apo dhe jashte saj, te cilat krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku do te ngrihen.

KREU I DYTE

KAPITALI DHE FITIMI

NENI 6

Kapitali fillestar I shoqerise eshte 100.000 leke. Pjesa e ortakeve ne kapitalin fillestar te shoqerise eshte:

Ortaku I pare 50.000 leke ose 50%.

Ortaku I dyte 50.000 leke ose 50%.

Kapitali I derdhur per krijimin e kapitalit fillestar eshte ne leke. Kuotat e ortakeve dhe pjeset e kapitalit te shoqerise shenohen ne librin e llogarise se shoqerise. Ato mund te depozitohen ne nje nga bankat e Shqiperise, ku shoqeria do te cele llogarine rrjedhese te saj.

Ne librin e llogarise krijohet fondi themelor I shoqerise, ku shenohen kapitalet e vena nga seicili ortak.

Ortaket nuk kufizohen ne rritjen e kontributit te tyre, I cili mund te jete ne leke ose ne natyre me vleresim nga te dy palet.

NENI 7

Pjesemarresit ne kapitalin baze te shoqerise kane te drejten e pronesisë mbi te. Pjesmarrja ne shoqeri nuk I pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative apo pronesisë edhe jashte aktivitetit te shoqerise.

Ortaket qe marrin pjese ne shoqeri, nuk jane te nenshtruar ndaj saj edhe si persona. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e krijuara gjate aktivitetit ekonomik te shoqerise me shuma me te medha se sa ato qe kane derdhur si kontribut, per krijimin dhe funksionimin e saj. Po ashtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e krijuara prej tyre jashte aktivitetit te shoqerise.

NENI 8

Ortaket nepermjet Asamblese se Ortakeve kane te drejte te marrin pjese dhe te kerkojne te dhena mbi administrimin e veprimtarise se shoqerise, te bejne propozime ne Asamble ne perputhje me kete statut dhe Kontraten e Themelimit.

Ortaket jane te detyruar te depozitojne kuotat e tyre dhe kuotat suplementare eventuale, te marrin pjese ne administrimin e shoqerise, te japin informata te ndryshme ne interes te shoqerise, te realizoje sherbime per kete qellim e te tjera, gjithmone ne perputhje me Kontraten dhe Statutin.

NENI 9

Cdo ortak ka te drejte te heqe dore nga shoqeria, duke ja bere te ditur vendimin e tij me shkrim ortakut tjeter nje muaj me pare.

Heqja dore nuk e liron ortakun nga obligimet e marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj ortakut.

Ortaku I cili heq dore duhet ti ofroje pjesen e tij ortakut tjeter. Kur ortaku tjeter nuk pranon blerjen brenda tridhjete diteve nga njoftimi, ortaku doreheqes mund tia shese pjesen e tij personave te trete, por jo me cmim me te ulet nga ai qe I eshte ofruar ortakut te pare.



NENI 10

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj per shkaqe te forcave madhore ose ne marreveshje ndermjet dy ortakeve dhe me miratimin e organit administrativ, pasi kryen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave (perfshire edhe te ardhurat qe do te merren nga shitjet e asetëve), jua ndan ortakeve perpjestimisht me pjesen qe I takon secilit ne kapitalin e shoqerise.

Kur shoqeria vendos te pushoje veprimtarine e saj dhe ne marreveshje ndermjet dy ortakeve dhe me miratimin e organit administrativ, vendos ta shese objektin komplet nje shoqerie apo individi tjetër, te ardhurat nga shitja ndahen midis dy ortakeve perpjestimisht me pjesen qe I takon secilit ne kapitalin e shoqerise.

NENI 11

Shoqeria duhet te siguroje pjeserisht, teresisht ose jo objektet e saj. Nerast demtimi te objekteve te siguruara nga pakujdesia e personelit ceshtja do ti kaloje organeve kompetente ligjore, dhe zhdemtimi do te behet sipas vendimit te tyre.

NENI 12

Marrja ne pune ne shoqeri behet me kontrate, ne te cilen percaktohen te drejtat dhe detyrimet e paleve, ne perputhje me legjislacionin qe rregullon maredheniet e punes. Kontraten me cdo punonjes e lidh administratori.

Shoqeria merr persiper zbatimin e dispozitave ligjore per sigurimet shoqerore dhe atyre per mbrojtjen dhe sigurimin ne pune, per kete qellim ajo krijon fonde te vecanta dhe lidh marreveshje me organet perkatese shteterore.

Mosmarreveshjet qe lindin nga Kontrata e punes do te zgjidhen nga Gjykata ne baze te dispozitave ligjore per maredheniet e punes.

NENI 13

Shoqeria percakton keto fonde:

- Fondi themeltar.
- Fondi rezerve.

Gjate aktivitetit te shoqerise mund te krijohen edhe fonde te tjera.

Fondi themelor I shoqerise krijohet nga kuotat e derdhura te ortakeve.

Fondin themelor shoqeria e perdor per te zhvilluar aktivitetin e saj.

Ne rast rreziku perdor fondin rezerve.

Perberja, shuma totale, menyra e krijimit te fondit rezerve dhe menyrat e perdorimit te tij vendosen nga Asambleja e Ortakeve, ne pershtatje me legjislacionin Shqiptar.

Shoqeria disponon plotesisht mbi fondet e saj financiare.

Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate aktivitetit te shoqerise, mbulohen nga fondi rezerve, ose nga fonde te tjera, apo dhe me shuma te tjera suplementare, qe mund te derdhen ortaket, ne perpjestim me kapitalin e secilit, ne rast se fondet nuk mjaftojne.

NENI 14

Shoqeria me vendim te Asamblese se Ortakeve mund te siguroje fonde plotesuese duke siguruar pjesmarrje ne investime te reja, ose me kontrata me investime te reja.

NENI 15

Shoqeria eshte pronare per ato sende per te cilat gezon kete te drejte dhe per te tjera, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj.

Shoqeria mund te bleje dhe te shfrytetoje dhe te drejta te tjera materiale ose jo duke perfshire ketu edhe te drejten per te ofruar pasurite e veta dhe per te marre kredi bankare.



Ne Shqiperi shoqeria gezon te drejttat per mbrojtjen e pasurise se saj si cdo shoqeri tjeter, person juridik ose fizik vendas, ne perputhje me legjislacioni Shqiptar ne fuqi dhe ato qe mund te dalin ne plotesim apo ne modifikimin e tyre.

NENI 16

Fitimin e realizuar, shoqeria ua shperndan ortakeve ne perpjestim me kuoten e pjesmarrjes se secilit ortak ne kapitalin e shoqerise, pasi te jene shlyer detyrimet e parashikuara nga ligja.

Nje pjese e fitimit mund tju shperndaht edhe punonjesve te shoqerise me vendim te asamblese se ortakeve.

NENI 17

Humbjet eventuale mbulohen nga kapitali I investuar prej ortakeve. Humbjet mbulohen dhe me te gjitha pasurite e shoqerise. Ne se humbja eshte shkaktuar per faj te administratorit, ai eshte I detyruar te kompensoje demet edhe me parate e tij private.

NENI 18

Pasurite e shoqerise vleresohen ne bilancet e saj me vlera te shkruara ne monedha shqiptare, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi ne Republikn e Shqiperise. Forma e bilanceve dhe llogarive ekonomike te shoqerise, caktohen nga administratori I saj duke patur parasysh dhe formen e bilanceve dhe llogarive ekonomike te vendosura per shoqerite dhe organizmat e tjera ne planin e pergjithshem kontabel te Shqiperise. Bilancet vjetore duhet te paraqiten brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

KREU I TRETË

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE, TE DREJTAT DHE DETYRAT E TYRE

NENI 19

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e ortakeve.
2. Administratori I shoqerise.
3. Komisioni I kontroll revizionit.

Administrator I shoqerise emerohet zoti Roland Jarani.

NENI 20

Asambleja e Ortakeve eshte organ vendimor dhe perbehet nga te gjithë ortaket e shoqerise.

Asambleja drejtohet nga nje president I cili eshte administrator I shoqerise.

Mbledhjet e zakonshme te Asamblese behen cdo 6 muaj.

Mbledhja e Asamblese qofte e zakonshme qofte e jashtezakonshme thirret me kerkesen e aq ortakeve sa perfaqesojne 50 perqind te kapitalit te shoqerise.

Asambleja e ortakeve vendos per aktivitetin e shoqerise, per bilancet vjetore, per ndryshimet ne statut per te shtuar apo pakesuar kapitalin e shoqerise per ndryshimin e administratorit dhe per pushimin (ndalimin) e aktivitetit te shoqerise.

Vendimet e asamblese se Ortakeve qofte ne mbledhje te zakonshme apo te jashtezakonshme merren me miratimin e te pakten aq votave sa perfaqesohen 2/3 e kapitalit te shoqerise.

NENI 21

Administratori I shoqerise mund te zgjidhet edhe nje person qe nuk eshte nder ortaket.



Ai zgjidhet per nje periudhe 6 mujore mbas te ciles bie nga fuqia por mund te zgjidhet perseri.

Te drejtat dhe detyrat e administratorit jane:

Therret asamblene e ortakeve, miraton programet dhe llogarite ekonomike, pas hartimit dhe perpunimit te tyre nga administrata, I propozon Asamblese se Ortakeve ndryshimet e mundeshme ne kapitalin e shoqerise, percakton programin vjetor dhe afatgjate te shoqerise, miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar te shoqerise, vendos per ndryshimet ne formen e organizimit te shoqerise, emerone dhe shkarkon komisionin e revizionit te shoqerise, vendos per krijimin ne rast nevojte te organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise, te njesive te tjera strukturore, si filiale e te tjera paraqit propozim per pushimin e veprimtarise se shoqerise, celje leterkreditit ne lek dhe ne valute te huaj, lidh kontrata, percakton numrin e punonjesve dhe pagat e tyre.

Organizon dhe realizon planet e shoqerise, perfaqeson shoqerine para te treteve ne te gjitha aktivitetin e saj, lidh e nenshkruan kontrata ne emer dhe per llogari te shoqerise dhe ndjek e siguron realizimin e tyre, raporton para Asamblese se Ortakeve dhe pergjigjet para tyre per veprimtarine e shoqerise, dhe per realizimin e objektivave dhe funksioneve, ne kuadrin e kompetencave te tij, ben emrimin e punonjesve te shoqerise dhe pushimet e tyre ne rastet e kur veprimet e tyre bien ndesh me interesat e shoqerise, dispozitat e percaktuara ne kete Statut dhe ne Kontraten e Themelimit, apo ne kontraten e lidhur me punonjesit, perzgjedh anetaret e komisionit te likuidimit.

NENI 22

Per te kontrolluar veprimtarine financiare dhe ekonomiko tregtare te shoqerise dhe filialeve te mundshme te saj, mund te krijohet nje komision revizioni I perbere nga nje kryetar dhe revizor, te cilet emerohen nga administratori I shoqerise, per nje afat te percaktuar prej tij. Kryetari dhe anetaret e ketij komisioni nuk duhet te jene punonjes te shoqerise apo te filialeve te saj. Komisioni I revizionit eshte pergjegjes per veprimtarine e vet para Administratorit dhe I paraqet atij raporte per kontrollin e kryer.

NENI 23

Shoqeria shperndahet ne forme organizimi ose likuidimi. Kur shoqeria likuidohet, Administratori emerone komisionin e likuidimit I cili paraqet bilancin e likuidimit. Shoqeria I jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te bilancit te likuidimit.

Mjetet financiare te fituara si rezultat I veprimtarise se shoqerise ose te filialeve te saj si dhe fondet e tyre financiare ndahen midis ortakeve ne perpjestim me kuoten e dhene prej tyre pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

NENI 24

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin mes ortakeve si dhe cdo problem qe mund te lindi gjate zhvillimit te aktivitetit te shoqerise qe nuk zgjidhen me mirkuptim ose ne zbatim te statutit, zgjidhen nga organet gjyqesore te Tiranës.


NENI 25

Gjithe aktet dhe dokumentet e shoqerise, dhe gjithe korespondenca dhe komunikimi ndermjet ortakeve, apo ortakeve dhe shoqerise, duhet te perpilohen ne gjuhen shqipe.

Aktet e redaktuara pa respektuar kerkesen e ketij neni jane te pavlefshme.

NENI 26

Ky statut u redaktua dhe u shtyp ne kater kopje te barasvlefshme juridikisht dhe hyn ne fuqi ne ditën e nenshkrimt nga ortaket.



Nje kopje eshte per ortakun e pare, nje per ortakun e dyte, nje per zyren e noterise,
dhe nje per gjykatën.

TIRANE me


ORTAKU I PARE



Roland JARANI



ORTAKU I DYTE



Ilir JARANI

